

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

"Ndertim i kendit të lojrave BE per femijet Rreshen EU4M , Bashkia Mirditë

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi sipas FPP- **45000000-7**

VLERA E FONDIT LIMIT: 3 095 155 (tre milion e nentëdhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë e pesë) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti kontraktor Bashkia Mirditë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1. Kandidati/Ofertuesiduhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Kandidati/Ofertuesiduhettëdorëzojë

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (Shtojca 8)

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe sipas dokumentave standarte të miratuara me ndryshimet e fundit ne dt. 05.10.2022, “Për miratimin e dokumentave standarte të tenderit për mallra,punë,shërbime për procedurën e prokurimit “procedurë e hapur”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve te fundit (2020,2021 dhe 2022) duhet te mos jete me e vogel se 40 % e fondit limit te tenderit. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ku minimalisht te arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c dhe neni 55, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe në pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe bazuar ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore,lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet, per vitin **2022** sipas ligjit 9632/2006 ”Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

(Per plotesimin e kriterit te mesiperm, eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates sipas shtojces Nr.8 (Formulari permbledhes i vetedeklarimit).

Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit t e fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”, ”d”, “dh”, “e”, “h”, ”i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne original ose ne kopje te njehsuara me origjinalin).

Pika 2.2.2 konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë në fazën e ofertimit plotësojnë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit , sipas shtojcës 8 .

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 2, e LPP, si dhe nenin 41, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kriteri i pikës 2.2.2 u vendos në referencë te nenit 76, pika 2 të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe u vlerësohet të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe konkretisht në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në KREU II, Taksat Vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin E Taksave Vendore, (i ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të ushtrorjnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës, me qëllim që fituesi i mundshëm të jetë në gjendje për të zbatuar në mënyrë sa më korrekte kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3 Per kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se **30%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Ose

deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit të jetë në një vlerë jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh duhet te paraqitet si vijon:

- Kontrata e Bashkim Operatoresh deklaruar ne fazen e tenderimit
- Prokura e posacme e Bashkim Operatoresh deklaruar ne faze tenderimi

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me sektorin publik,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
 - Fature tatimore perkatese.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatëtri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 55, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Të ketë mesatarisht të punësuar minimalisht 20 (njetzet) persona për periudhën (Janar 2023 e ne vazhdim), të vërtetuar me:Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kerkuar, si dhe me formularët E-SIG.

ARGUMENTIMI: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e

objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht analizat e çmimeve janë hartuar sipas parashikimeve të VKM Nr.514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar. Në pikën 2 të VKM së sipërcituar parashikohet se: “Hartimi i çdo preventivi apo situacioni në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimi e mbikëqyrja e çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen në përputhje me këtë vendim”. Mbi bazen e kesaj VKM referuar zerave te preventivit eshte bere perllogaritja e numrit te punonjesve dhe numrit te mjeteve, sipas secilit tip apo lloj.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikime te duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt per kete operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacion se ka si te punesuar dhe te re gjistruar ne kompanine e tij:

1(një) inxhinier ndërtimi	1(një)
1(një) inxhinier gjeodet	1(një)
1 nje arkitekt	1(një)
1 nje inxhinier elektrik	1(një)

Të shoqëruara për secilin punonjës me diplomë, kontratë te vlefshme pune, si dhe deklaratën që nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera.

ARGUMENTIMI: Kjo kerkese eshte hartuar mbi bazen e parashikimeve te VKM Nr.42 date 16.01.2008; Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar., sipas te ciles, “Drejtues teknik”- individ/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që janë është/jane përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Ne rastin konkret, ne projekt-preventivin dhe specififikimet teknike, jane parashikuar punime ndertimore, arkitektuore, ne rrjetin elektrik, instalime elektronike, punime hidraulike, punime mjedisore dhe rlevime te ndryshme mjedisore dhe per kete arsye, per realizimin e punimeve ne fjale jane kerkuar inxhinieret, drejtues teknik sipas profileve dhe profesioneve perkatese. Numri I tyre eshte bere nisur nga sasite e medha te cdo zeri punimesh ne preventive dhe dhe natyren komplekse te objektit te kesaj kontrate.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **muajin e fundit**, te paisur me kontrate pune (te vlefshme), ose te kontraktuar ne rastin kur makinerite jane me qera per manovraret, me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jenë të paktën:

-Teknik ndertimi	1(nje) punonjes
-Elektracist	1(nje) punonjes
-Bojaxhi	1(nje) punonjes

Argumentimi: Kjo kerkese eshte hartuar ne perputhje me VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: ” Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit”. Te gjithë specialistet e sipercituar jane kerkuar pasi ne preventive jane realizuar punime per realizimin e te cilave nevojiten keta punonjes dhe numri i tyre eshte percaktuar si numer minimal i nevojshem per realizimin e punimeve respective.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencat e nevojshme (lëshuar nga QKL) për zbatimin e punimeve objekt kontrate (BE EU4M-CfP-2-A11) , për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencë të vlefshme - Kodi III.2.B “*Për grumbullim, transportim të mbetjeve inerte*”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), e vlefshme.

ARGUMENTIMI: Kjo kerkese eshte bere ne perputhje me nenin 44 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: „Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te kete ne stafin e tij mjekun e shoqerise,ne zbatim te VKM N r.742, date 06.11.2003. Per kete duhet te paraqese kontraten e vlefshme te punes, Lejen e profesionit nga Urdheri i Mjekut dhe diplomen. Ne rast bashkimi te Operatoreve Ekonomike secili nga operatoret duhet ta kete ne stafin e tij mjekun e shoqerise.

Nëse OE nuk kanë personat e ngarkuar përgjegjës, me aftësi dhe kualifikimet e duhura, prane se nuk kane mjek te punesuar, mund t’I sigurojnë këto shërbime me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Argumentimi: Ne lidhje me kriterin për mjekun e shoqërisë, AK eshte referuar në VKM Nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar me VKM

Nr.632, date 15.07.2015, ku parashikohen mënyrat e sigurimit të shërbimeve mjekësore, në bazë të numrit të punonjësve që punëdhënësit kanë të punësuar në subjektet e tyre, dhe sipas sektorëve të industrisë, të përcaktuara në këtë VKM, ku parashikohet domosdoshmeria e mjekut, në bazë të numrit të punonjësve që punëdhënësit kanë të punësuar në subjektet e tyre, dhe sipas sektorëve të industrisë, të përcaktuara në këtë VKM.

2.3.5 Operatorët ekonomik duhet të disponojnë licensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Shqyrtimi i licensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara në sa më sipër.

Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Përpunimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licensat e mëposhtme:

NP-1/ A Punime gërmimi në tokë.

NP - 12 A Punime inxhinierise se mjedisit

Përpunimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licensat e mëposhtme:

NS - 1/ A Punime për prishjen e ndërtimeve

NS-18/ A Punime topogjeodezike

NS-4 /A Punime rafiniture të muratës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe në klasifikimin e niveleve (germave) për punimet sipas natyrave respektive, të parashikuara në VKM Nr.42 datë 16.01.2008; Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar. Në çdo rast, për secilën kategori licence, është përcaktuar niveli (germa) duke u nisur nga vlera e punimeve të parashikuara në preventiv dhe/apo në specifikimet teknike. (Shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licensës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licensë)

2.3.6 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e

shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, (kjo per gjithestafinteknik).

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe kane dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, shtojca 10.

Mjetet	Sasia	Gjëndja
Kamion me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton	2 (copë)	Pronësiose me qera
Fadrome me goma	1 (copë)	Pronësiose me qera
Minieskavator	1 (copë)	Pronësiose me qera
Autobetoniere vetengarkuese	1 (copë)	Pronësiose me qera
Autobot Uji 3-5 ton	1 (copë)	Pronësiose me qera
Matrapik	1 (copë)	Pronësiose me qera

- Për paisjet teknike, kur jane në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes ose kontratatë shit blerjes. Kur jane me qera duhet të paraqiten kontratatë qerases, faturat tatimore të shitjes ose kontratatë shit blerjes. Faturat qe nuk jane sipas formatit te miratuar me tvsh (faturate biznesit te vogel) duhet te shoqerohen me kuponin tatimor.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (lejeqarkullimi), çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshem i mjetit dhe fotot e tyre. Kur jane me qera, duhet të paraqitet kontrata e qerases, dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (lejeqarkullimi), çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshem i mjetit dhe fotot e tyre.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo cdoganimit, fotot ose fatura tatimore perkatese. Kur jane me qera, duhet të paraqitet kontrata e qerases, kontrata e blerjes apo cdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht analizat e çmimeve jane hartuar sipas parashikimeve të VKM Nr.514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve

të ndërtimit”, i ndryshuar. Në pikën 2 të VKM së sipërcituar parashikohet se: “Hartimi i çdo preventivi apo situacioni në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimi e mbikëqyrja e çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen në përputhje me këtë vendim”. Mbi bazen e kesaj VKM referuar zerave të preventivit është bere perlllogaritja e numrit te punonjesve dhe numrit te mjeteve, sipas secilit tip apo lloj.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë“ lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim ose ekuivalentin e saj
- **OHSAS 18001:2015 ose ekuivalente 45000** mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” ose ekuivalentin e saj
- ***Operatori ekonomik duhet të vendose Lodra (te reja) te cilat duhet te jene sipas standartit dhe te shoqerohen me katalog te leshuara nga prodhuesi ose distributori i autorizuaranga prodhuesi per mallrat e kerkuara.***

Çertifikatat kerkohet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Ne rast bashkimi te Operatoreve Ekonomike secili nga operoret duhet te disponoje keto certifikata sipas punimeve qe merr persiper.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të leshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Ne respektim te nenit 36, 37 të LPP-se në të gjitha rastet kur permendet “marke” perfshihet termi “ekuivalent”.

Sqarim per ofertuesit: Ne respektim dhe zbatim te **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,neni 26 neni 39, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 te VKM nr.285, date 19.05.2021.**

Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

ARGUMENTIMI: Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës dhe nuk permbajne asnje reference te ndonje market e vecante, duke pershkruar ne menyre te qarte dhe te kuptushme çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ne perputhje me me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT